



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

Nr 903 Prot.

Gjirokastrë, më 24 / 04 / 2020

**V E N D I M**

Nr. 09 , datë 24.04.2020

**MIRATIMI I RISHIKIMIT TË KUOTAVE TË PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK  
2020 -2021 PËR PROGRAMET E CIKLIT TË PARË, CIKLIT TË DYTË DHE  
PROGRAMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL NË UNIVERSITETIN "EQREM  
ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Në zbatim të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 14 pika 10 dhe rekomandimeve të projekt raportit të MASR –së, " Mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit sipas kuotave të deklaruara nga Universiteti "Eqrem Çabej, për vitin akademik 2020 -2021 " dhe në zbatim të VKM-se nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen riorganizimin, ndarjen , bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe degëve të tyre" Aneksi 1/C, Rektorati i Universitetit "Eqrem Çabej" rishikoi kuotat e pranimi të studentëve për vitin akademik 2020 – 2021 dhe në mbledhjen e tij të datës 24.04.2020 ;

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë ndryshimin e kuotave të pranimi për programet e ciklit të parë "Bachelor", ciklit të dytë "Master " , "Master Profesional" , dhe programeve me karakter profesional 2-vjeçar për vitin akademik 2020 - 2021 në Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore përkatësisht në programet e studimit si mëposhtë:

Fakulteti Ekonomik			
Emertimi i programit të studimit	Cikli i studimit	Kuotat	Kuotat e ndryshuara
Kontabilitet Finance	Bachelor	75	55
Administrim Publik	Bachelor	75	55
Turizëm	Bachelor	30	25
Kontabilitet –Finance	Master Profesional	72	60
Adminitrim Publik	Master Profesional	72	60
Turizëm	Master Profesional	30	25
Ndihmës Ekonomist	Program Profesional	50	45
Asistent Administrativ	Program Profesional	50	45
Asisten Menaxher në Shërbimet Turistike	Program Profesional	50	45
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore			
Gjuhë Angleze	Master	40	35
Histori Gjeografi	Master	55	43
Librar dhe Bibliotekar	Program Profesional	50	40
Udhërrefyes Turistik	Program Profesional	40	35

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Prof. dr Bektash MEMA

REKTOR

